



**REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT/ TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI/
PROCUREMENT REVIEW BODY**

Në bazë të nenit 105 pika 1 dhe 2 si dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, Kryetari i OSHP-së z. Hysni Hoxha me datën 17.12.2012 nxori këtë:

U R D H Ë R E S Ë

- I. Urdhërohet Autoriteti Kontraktues pranë KK Gjilan, që ta zbatoj vendimin e PSH-së Nr. 333/12, të datës: 06.12.2012 lidhur me aktivitetin e prokurimit „**Mirëmbajtja Dimërore e rrugëve 2012/2013, në Komunën e Gjilanit – Ndarja në dy Lote**”, me Nr. të Prokurimit:GI 651/12/111/221.
- II. Organi Shqyrtues i Prokurimit, urdhëron AK-së, që ta anulojë vendimin për dhëni të kontratës në KRPP, të dt:13.12.2012, lidhur me aktivitetin e prokurimit “**Mirëmbajtja Dimërore e rrugëve 2012/2013, në Komunën e Gjilanit – Ndarja në dy Lote**”, me Nr. të Prokurimit:GI 651/12/111/221.
- III. Organi Shqyrtues i Prokurimit me vendimi me nr. të protokollit 333/12 të datës : 06.12.2012, e ka urdhëruar Autoritetin Kontraktues- KK Gjilan, që aktivitetin e prokurimit “**Mirëmbajtja Dimërore e rrugëve 2012/2013, në Komunën e Gjilanit – Ndarja në dy Lote**”, ta Ri vlerësoj.
- IV. Operatori ekonomik “TALI”- Gjilanë, me datën: 17.12.2012 ka njoftuar OSHP- në se me rastin e rivlersimit AK-së nuk e ka zbatuar vendimin e OSHP-së, të dt:06.12.2012, duke rekomanduar për kontratë Operatorin e njejtë ekonomik. AK-së me dt:13.12.2012, ka njoftuar OSHP-në me ri-vlersimin, ku ka rekomanduar për dhënie të kontratës të njeitin OE.

- V. Organi Shqyrtues i Prokurimit, konstaton se vendimi i Panelit Shqyrtues të PSH-së nr. 333/12, është vendim përfundimtar apo i formës së prerë për aktivitetin e prokurimit “**Mirëmbajtja Dimërore e rrugëve 2012/2013, në Komunën e Gjilanit – Ndarja në dy Lote**”, andaj Autoriteti Kontraktues është i obliguar që gjatë procesit të rivlerësimit të ofertave t’i respektoj ne tërësi të gjitha rekomandimet e dhëna nga Paneli Shqyrtues.
- VI. Mos respektimi i vendimit të datës 06.12.2012, e detyron Panelin Shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të LPP-së, ndaj Autoritetit Kontraktues të vendosë një gjobë prej jo më pak se 5000.00€ (pesëmijë euro), kurse ndaj Zyrtarit të Prokurimit OSHP-ë do të jetë e obliguar që konform nenit 25 pika 8 e LPP-së të marrë vendim për marrjen e certifikatës së prokurimit, për bishtrim-ikje të përmbartimit të vendimit të OSHP-së.
- VII. Kjo urdhëresë hyn në fuqi brenda pesë (5) ditëve, nëse Autoriteti Kontraktues nuk e zbaton -përmbaron vendimin e Panelit Shqyrtues nr. 333 /12 të datës: 06.12.2012.

Urdhëresa i dërgohet :

**Dep. Prokurimit të
KK Gjilan
Arhives së OSHP-së
OE “TALI” nga Gjilani**

